



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa :Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", tiranë-Albania, Tel:04224332

Nr. 1351 / Prot.

Tiranë, më 31/12/2017

URDHËR

Nr. 219 , Datë 31/12 2017

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË POSAÇME
PËR PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË HETIMIT ADMINISTRATIV TË
SINJALIZIMIT, MEKANIZMAT E MBROJTJES SË KONFIDENCIALITETIT
DHE MBROJTJES NGA HAKMARRJA NË KONTROLLIN E LARTË TË
SHTETIT

Në zbatim të pikës 1 dhe 2 të nenit 10 të ligjit nr. 60/2016, datë 02.06.2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", të pikës 1 dhe 2 të Vendimit të këshillit të ministrave nr. 816, datë 16.11.2016 "Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, 'Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve'",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores së brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit, mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes nga hakmarrja në Kontrollin e Lartë të Shtetit
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri njësi përgjegjëse.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Bujar LESKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Nr. 1351 prot

Datë 31/12/ 2017

RREGULLORE
E BRENDSHME E POSAÇME
PËR PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË HETIMIT
ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT, MEKANIZMAT E
MBROJTJES SË KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES
NGA HAKMARRJA
NË KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT

Tiranë, 2017

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit, mbrojtjen e konfidencialitetit dhe të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Kontrollin e Lartë të Shtetit, bazohet në pikën 10, të nenit 13 dhe pikën 8, të nenit 19 të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Kodin e Procedurave Administrative, VKM-në nr. 816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr.60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Urdhrin nr. 26, datë 27.01.2017 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI.

Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit, të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja, si dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet publik”, ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për të drejtën e informimit.
2. “Hakmarrje”, është çdo veprim i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, ose kërcënim, i kryer nga institucioni, me natyrë diskriminuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.
3. “I sinjalizuar”, janë një ose më shumë persona ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
4. “ILDKPKI”, është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
5. “Informacion publik”, ka të njëjtin kuptim të dhënë në ligjin për të drejtën e informimit.
6. “Korrupsion”, është çdo veprim ose mosveprim i kundërligjshëm, sipas legjislacionit penal në fuqi, në lidhje me çdo formë të korrupsionit aktiv, korrupsionit pasiv, shpërdorimit të detyrës ose kompetencave, ushtrimit të ndikimeve të paligjshme në kryerjen e detyrave ose marrjen e vendimeve, shpërdorimit të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, përfitimit të paligjshëm të interesave, si dhe çdo akt tjetër i ngjashëm me to.

7. "Mbrojtje", është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas mekanizmit të përcaktuar në kreun V të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".
8. "Njësia përgjegjëse", është organi i posaçëm i caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat, i përbërë nga një ose më shumë punonjës të organizatës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit.
9. "Organizatë", është autoriteti publik ose subjekti privat.
10. "Sinjalizim", është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit te njësia përgjegjëse ose te ILDKPKI-ja, për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik apo subjektin privat.
11. "Sinjalizim i brendshëm", është raportimi i kryer nga sinjalizuesi brenda njësisë përgjegjëse të organizatës, sipas nenit 10 të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".
12. "Sinjalizim i jashtëm", është raportimi i kryer nga sinjalizuesi pranë ILDKPKI-së, sipas nenit 11 të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".
13. "Sinjalizues", është individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
14. "Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni", është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.

Neni 4 Bashkëpunimi

Në zbatim të parimit të ruajtjes së konfidencialitetit, sekretit shtetëror dhe mbrojtjes së të dhënave personale, njësia përgjegjëse bashkëpunon me ILDKPKI-në dhe homologe të saj në institucione të tjera për shkëmbim të dhënash të plota dhe pa asnjë rezervë, me qëllim shqyrtimin dhe zgjidhjen e një rasti të sinjalizuar kur, pavarësisht nga institucioni i sinjalizuesit, të sinjalizuarit i përkasin institucioneve të ndryshme.

KREU II NJËSIA PËRGJEGJËSE

Neni 5 Emërimi i njësisë përgjegjëse dhe parimet e veprimitarisë së saj

1. Njësia përgjegjëse në Kontrollin e Lartë të Shtetit është krijuar me Urdhrin nr. 26, datë 27.01.2017 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Njësia përgjegjëse përbëhet nga drejtuesi i strukturës së auditimit të brendshëm dhe një nëpunës i saj, ose një nëpunës tjetër i caktuar me urdhër të veçantë të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në njësinë përgjegjëse mund të marrin pjesë edhe auditues të tjerë me përvojë pune mbi 20 vjeçare në KLSH të cilët kanë dalë në pension 2-3 vitet e fundit.
3. Emërimi i njësisë përgjegjëse i dërgohet edhe ILDKPKI-së, së bashku me kontaktet e tyre.
4. Njësia përgjegjëse në Kontrollin e Lartë të Shtetit, për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, bazohet në parimet e:
 - a. Ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit dhe sekretit shtetëror.
 - b. Njohjes së identitetit të sinjalizuesit, përveç rastit kur ligji lejon pranimin e një sinjalizimi anonim.
 - c. Sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktike të dyshuar të korrupsionit.
 - d. Integritetit dhe paanshmërisë gjatë shqyrtimit të sinjalizimit.
 - e. Zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit.
 - f. Procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.
5. Emërimi në njësinë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Kontrollin e Lartë të Shtetit, krahas detyrave dhe funksioneve të pozicionit të punës sipas aktit të emërimit, është pa afat dhe përfundon me mbarimin e marrëdhënieve në atë pozicion pune.

Neni 6

Shkarkimi i anëtarëve të njësisë përgjegjëse

1. Për çdo ndërprerje të marrëdhënies së punës së anëtarëve të njësisë përgjegjëse, informohet menjëherë ILDKPKI-ja. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit merr masat e nevojshme që të zëvendësojë menjëherë nëpunësin/punonjësën e larguar të njësisë përgjegjëse me punonjës të strukturës përkatëse ose, sipas rastit, të strukturave të tjera, duke zbatuar kriteret e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore.
2. Nëpunësit/punonjësët e njësisë përgjegjëse largohen nga kjo detyrë me urdhër të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, kur:
 - a. Kryejnë shkelje të rëndë të legjislacionit që rregullon sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.
 - b. Përfundon marrëdhënien e punës me autoritetin publik.

Neni 7

Kompetencat dhe detyrat kryesore të njësisë përgjegjëse

1. Njësia përgjegjëse ka për detyrë:
 - a. të kryejë detyrat e përcaktuara në ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;
 - b. të veprojë me ndershmëri, integritet, paanshmëri, efikasitet dhe jashtë çdo influence të padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave të saj;

- c. të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme gjatë procedurës së shqyrtimit, në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit;
 - ç. të regjistrojë sinjalizimet, të kryejë procedurën e hetimit administrativ, të marrë vendim për përfundimin e hetimit administrativ apo mosfillimin e tij dhe ta dokumentojë atë;
 - d. të marrë të gjitha masat për shqyrtimin e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje të sinjalizuesit;
2. Njësia përgjegjëse vepron në mënyrë të pavarur dhe jashtë çdo influence tjetër, të padrejtë, që mund të pengojë realizmin e detyrave të saj në zbatim të ligjit nr.60/2016.
 3. Njësia përgjegjëse duhet të ruaj në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur apo transmetuar te persona të tretë brenda ose jashtë institucionit, si dhe të mos e përdorë për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.
 4. Njësia përgjegjëse zbaton detyrat e ngarkuara nga ILDKPKI-ja, për lehtësimin dhe zhvillimin e procesit të sinjalizimit, si dhe i paraqet ILDKPKI-së çdo vit jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raport me shkrim për sinjalizimet e regjistruara, mënyrat e ndjekura për hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Neni 8

Vendimarrja e njësisë përgjegjëse

1. Njësia përgjegjëse kryesohet nga drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm në Kontrollin e Lartë të Shtetit.
2. Drejtuesi i njësisë përgjegjëse përfaqëson njësinë në marrëdhënie me palët e treta.
3. Rolin e sekretariatit të njësisë përgjegjëse e kryen nëpunësi i njësisë përgjegjëse, i cili mban procesverbalin gjatë shqyrtimit administrativ, me shkrim ose audio. Procesverbali i zbardhur nënshkruhet nga njësia përgjegjëse.
4. Nëpunësi i njësisë së auditimit, administron regjistrat e sinjalizimeve dhe vendimarrjeve të njësisë përgjegjëse.
5. Vendimet e njësisë përgjegjëse nënshkruhen nga drejtuesi i njësisë përgjegjëse.
6. Vendimi i njësisë përgjegjëse duhet të përmbajë këto elemente:
 - a. Përbërjen e njësisë përgjegjëse.
 - b. Kohën dhe vendin e dhënies së vendimit.
 - c. Objektin e sinjalizimit.
 - ç. Të sinjalizuarin.
 - d. Pjesën arsyetuese të vendimit.
 - dh. Dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi.

Neni 9
Administrimi i dokumentacionit

1. Për çdo sinjalizim mbahet dosje e veçantë ku administrohen të gjitha dokumentat që nga vlerësimi fillestar deri në përfundim të shqyrtimit administrativ.
2. Dosja e sinjalizimit përmban vendimin për mosfillimin ose përfundimin e hetimit administrativ, të arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.
3. Në përfundim të të gjithë procesit, dosjet dorëzohen në protokoll, sipas ligjit për arkivat.

KREU III
PROCEDURAT E VEPRIMIT

Neni 10
Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale të njësisë përgjegjëse, kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat njësia përgjegjëse cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

Neni 11
Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para punonjësit të njësisë përgjegjëse dhe dokumentohet me shkrim prej këtij të fundit.
2. Sinjalizimi përmban të paktën:
 - a. të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;
 - b. të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
 - c. përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
 - ç. referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;
3. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga njësia përgjegjëse si i tillë, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.
4. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme, sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigojë këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim, duke i caktuar një afat për plotësimin e pasaktësive.

Neni 12
Mosfillimi i hetimit administrativ

1. Njësia përgjegjëse ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse:
 - a. sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
 - b. sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në pikën 6, të nenit 3 të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;
 - c. kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.
2. Mosfillimi i hetimit administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të njësisë përgjegjëse.

Neni 13
Hetimi i drejtpërdrejtë nga ILDKPKI

1. Sinjalizuesi ka të drejtë të sinjalizojë veprën e dyshuar të korrupsionit tek ILDKPKI-ja, në rastet kur;
 - a. njësia përgjegjëse nuk fillon hetimin administrativ ose përfundon hetimin në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 60/2016;
 - b. ekziston dyshimi i arsyeshëm se pritësi i sinjalizimit në njësinë përgjegjëse ose persona të lidhur me të, janë të përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, pasuror ose personal, me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Sipas rastit, person i lidhur ka të njëjtin kuptim me përcaktimet e bëra në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ose ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
 - c. ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e njësisë përgjegjëse, në shqyrtimin e sinjalizimit;
 - ç. prova e sinjalizuesit, në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, mund të fshihet ose të shkatërrohet nga institucioni.
2. Në rastet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, çdo hetim i njësisë përgjegjëse, nëse ka filluar, ndërpritet dhe sinjalizimi hetohet në vijim nga ILDKPKI-ja. Në rast se nuk vërtetohen kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, me vendim të arsyetuar, e dërgon sinjalizimin për nisjen ose vijimin e hetimit administrativ tek njësia përgjegjëse e organizatës.

KREU IV
HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 14
Regjistrimi i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokolli dhe elektronik, për regjistrimin e sinjalizimeve.
2. Njësia përgjegjëse nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 15
Parimet e hetimit administrativ

Në kryerjen e hetimit administrativ njësia përgjegjëse vepron:

- a. me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasyshë interesat legjitime të sinjalizuesit;
- b. në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;
- c. duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm, përpara fillimit të hetimit administrativ;
- ç. duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, fallsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
- d. duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe mbrojen e të dhënave në përmbajtje të çdo sinjalizimi;
- dh. duke ruajtur sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit.

Neni 16
Procedura e hetimit administrativ

1. Njësia përgjegjëse heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, njësia përgjegjëse zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njësia përgjegjëse ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
3. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga njësia përgjegjëse.
4. Çdo pale pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:
 - a. mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
 - b. mund të konsultohet me dosjen e hetimit;

- c. ka të drejtë të dëgjohej në lidhje me pretendimet e tij.
5. Njësia përgjegjëse njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, njësia përgjegjëse është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.
 6. Njësia përgjegjëse merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.
 7. Nëse në përfundim të hetimit administrativ nga njësia përgjegjëse rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative sipas ligjit, drejtuesi i njësisë përgjegjëse, sipas rastit vë në dijeni organin kompetent.

Neni 17 **Provat në hetimin administrativ**

1. Njësia përgjegjëse dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrativ merren apo pranohen pa pagesë. Çdo shkelje e detyrimit të zyrtarëve apo të institucioneve private për dhënie dokumentacioni shkresor apo dokumenti tjetër provues, përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor në varësi të shkeljes së konstatuar.
2. Njësia përgjegjëse ka të drejtë të këqyri sende, vende apo dokumentacion, me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë apo praktikës së dyshuar të korrupsionit. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër.
3. Në raste të veçanta, kur punonjësit e njësisë përgjegjëse vlerësojnë se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, bllokojnë dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet punonjësi i njësisë përgjegjëse dhe zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë. Zhblllokimi i dokumentacionit bëhet me urdhër të drejtuesit të njësisë përgjegjëse.
4. Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e njësisë përgjegjëse zbatojnë, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
5. Në fund të kontrollit mbahet akt-kontrolli, i cili nënshkruhet nga punonjësit e njësisë përgjegjëse dhe zyrtarët e organit shtetëror. Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktit.

Neni 18
Përfundimi i hetimit administrativ

1. Njësia përgjegjëse përfundon hetimin administrativ nëse:
 - a. gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar. Në këtë rast, njësia përgjegjëse njofton menjëherë prokurorinë ose Policinë e Shtetit.
 - b. sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.
2. Në dosjen e sinjalizimit shënohen vendimi për përfundimin e hetimit administrativ nga njësia përgjegjëse, i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

Neni 19
Afati për vendimmarrjen

1. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit nga njësia përgjegjëse përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.
2. Shtyrja e afatit për hetimin administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të drejtuesit të njësisë përgjegjëse duke përcaktuar edhe afatin e ri kohor të shtyrjes, në përputhje me vështirësinë dhe kompleksitetin e çështjes.

KREU V
RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 20
Konfidencialiteti

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
2. Njësia përgjegjëse duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.
3. Njësia përgjegjëse në komunikimet me organizatën ku punon sinjalizuesi, ose me çdo subjekt apo autoritet tjetër, privat ose shtetëror, respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ ose për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara, në kuadër të një marrëveshjeje konfidencialiteti mes palëve.

Neni 21
Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrative, përpunohen vetëm për qëllim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektim i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU VI
MBROJTJA NGA HAKMARRJA

Neni 22
Mbrojtja kundër hakmarrjes

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, sipas ligjit nr. 60/2016, mbrohet ndaj çdo mase hakmarrëse të marrë ndaj tij nga institucioni, duke përfshirë por pa u kufizuar në:
 - a. shkarkimin nga puna;
 - b. pezullimin nga puna, ose të një, ose më shumë detyrave;
 - c. transferimin brenda ose jashtë organizatës;
 - ç. uljen në detyrë;
 - d. uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
 - dh. humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
 - e. mosngritjen në detyrë;
 - ë. heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
 - f. vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
 - g. forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.
2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.
3. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të organizatës, për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, paraqet kërkesë me shkrim tek drejtuesi i organizatës dhe një kopje e saj i dërgohet Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

Neni 23
Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje

1. Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje, fillimisht duhet të paraqesë kërkesë për mbrojtje tek njësia përgjegjëse.

2. Njësia përgjegjëse merr menjëherë masat dhe në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës, vendos me akt të ndërmjetëm të arsyetuar për riparimin e pasojave të paligjshme nga akti i hakmarrjes. Në rast të shkeljes së këtij afati, kërkesa e sinjalizuesit paraqitet tek ILDKPKI-ja, që vendos brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, për riparimin e pasojave të paligjshme të aktit të hakmarrjes.

Neni 24

Hetimi administrativ dhe barra e provës

1. Njësia përgjegjëse heton administrativisht pretendimet për hakmarrje, për të përcaktuar nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ka ndodhur, është duke ndodhur, ose pritet të ndodhë një akt hakmarrjeje.
2. Njësia përgjegjëse, në hetimin administrativ, i kërkon me shkresë organizatës të provojë që masat e marra në dëm të sinjalizuesit janë bazuar në shkaqe të ndryshme dhe që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me sinjalizimin. Institucioni ka barrën e provës në këtë proces dhe i përgjigjet njësisë përgjegjëse me shkrim brenda 10 ditësh nga data e marrjes së kërkesës.

Neni 25

Bashkëpunimi

1. Institucioni dhe sinjalizuesi bashkëpunon me njësinë përgjegjëse në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes së aktit të hakmarrjes ndaj sinjalizuesit. Institucioni është e detyruar të paraqesë informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t'u paraqitur personalisht përpara njësisë përgjegjëse.
2. Institucioni çdo deklaram apo argument të saj e paraqet me shkrim.

Neni 26

Mjetet e kërkimit të provës

1. Gjatë hetimit administrativ njësia përgjegjëse me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, mund:
 - a. të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;
 - b. të marrë dokumente dhe çdo informacion tjetër të dokumentuar nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
 - c. të vizitojë vende të caktuara.
2. Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e çështjes së aktit të hakmarrjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj, njësia përgjegjëse kryesisht apo me kërkesën e sinjalizuesit, mund të vendosë marrjen më parë të kësaj prove (sigurimi i provës).
3. Njësia përgjegjëse që zhvillon procedurën administrative mund të vendosë sigurimin e provës edhe përpara fillimit të procedurës administrative. Sigurimi i provës mund të bëhet edhe në çdo fazë të procedurës administrative. Përgjegjësia për sigurimin e provave bie mbi njësinë përgjegjëse.

Neni 27
Njoftimi i sinjalizuesit

1. Njësia përgjegjëse njofton me shkrim sinjalizuesin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për statusin e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë.
2. Pavarësisht nga afatet e njoftimit, njësia përgjegjëse është e detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë për informacion me shkrim, paraqitur në çdo kohë nga sinjalizuesi në lidhje me kërkesën e tij.

Neni 28
Masat në përfundim të hetimit administrativ

Nëse në përfundim të hetimit administrativ rezulton se është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit nga autoriteti publik, njësia përgjegjëse i drejtohet me shkrim organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, për marrjen e të gjitha masave për riparimin e shkeljes së kryer. Njësia përgjegjëse parashikon në shkresë edhe rekomandimin konkret për llojin e masës që duhet të merret.

Neni 29
Afati i përfundimit të hetimit administrativ

Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

Neni 30
Miratimi

1. Rregullorja i përcillet Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI i cili si institucion lider në këtë fushë shton, plotëson, riformulon pika të veçanta të kësaj rregulloreje.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit me urdhër nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe në zbatim të nenit 25 të ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” i shtrin efektet juridike prej datës 1 tetor 2016.

K R Y E T A R

Bujar LESKAJ